# Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(me raportin e auditorëve të pavarur)

# Përmbajtja


| | Faqe |
|---|---|
| Raporti i auditorëve të pavarur | i |
| Pasqyra e Pozicionit Financiar | 1 |
| Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor | 2 |
| Pasqyra e ndryshimeve në kapital | 3 |
| Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor | 5 |
| Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 | 7-35 |

KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

## Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
Coca Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k

Tiranë, 28 mars 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Coca Cola Bottling Shqiperia Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2011, pasqyrat e të ardhurave përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

*Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

*Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619001D

KPMG

*Opinioni*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2011, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

# Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

*(shumat ne Lek)*

| | Shënimi | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | |
| Toka, ndërtesa dhe makineri | 6 | 1,321,913,832 | 1,319,407,127 |
| Investime financiare | 7 | 23,000,000 | 23,000,000 |
| Tatim i shtyrë | 8 | 921,820 | 635,868 |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | 1,345,835,652 | 1,343,042,995 |
| Inventari | 9 | 235,295,147 | 170,016,037 |
| Kërkesa për arkëtim nga debitorët | 10 | 56,349,016 | 85,855,585 |
| Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura | 11 | 29,838,590 | 3,902,625 |
| Aktive te tjera afatshkurtra | 12 | 49,438,357 | 51,351,718 |
| Tatim fitimi i parapaguar | | 21,233,514 | 16,482,024 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 13 | 189,060,464 | 327,746,189 |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | | 581,215,088 | 655,354,178 |
| **Totali i aktiveve** | | **1,927,050,740** | **1,998,397,173** |
| **Detyrimet dhe kapitalet e veta** | | | |
| Kapitali i nënshkruar | 14 | 1,493,040,000 | 1,493,040,000 |
| Rezerva ligjore | 15 | 29,987,807 | 29,987,807 |
| Rezerva te tjera | | 41,264,800 | 33,074,234 |
| Fitimi i mbartur | | 51,800,172 | 180,688,622 |
| **Totali i kapitalit aksionar** | | 1,616,092,779 | 1,736,790,663 |
| Tatim i shtyre | 8 | 20,092,608 | 21,874,632 |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | 20,092,608 | 21,874,632 |
| Detyrime ndaj palëve te lidhura | 16 | 866,541 | 8,104,214 |
| Detyrime ndaj furnitorëve | 17 | 210,528,251 | 148,273,570 |
| Detyrime te tjera | 18 | 79,470,561 | 83,354,094 |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | 290,865,353 | 239,731,878 |
| **Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta** | | **1,927,050,740** | **1,998,397,173** |

Shënimet, në faqet 7 deri 35, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

## Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

*(shumat në Lek)*

| | Shënimi | 2011 | 2010 |
|---|---|---|---|
| Të ardhurat nga shitjet | 20 | 2,485,822,615 | 2,367,448,745 |
| Kostoja e mallrave të shitura | 21 | (1,880,369,739) | (1,610,609,812) |
| **Fitimi bruto** | | 605,452,876 | 756,838,933 |
| Të ardhura të tjera | 22 | 118,955,197 | 37,579,767 |
| Shpenzime personeli | 23 | (222,939,939) | (163,734,953) |
| Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale | 6 | (59,840,757) | (54,679,691) |
| Shpenzime të tjera operative | 24 | (410,036,144) | (386,681,821) |
| **Shpenzimet operative** | | (573,861,643) | (567,516,698) |
| **Fitimi operativ para kostove financiare** | | 31,591,233 | 189,322,235 |
| Shpenzime financiare | | (1,862,971) | (22,205,568) |
| Të ardhura financiare | | 9,983,588 | 15,771,560 |
| **Të ardhura financiare/(shpenzime) neto** | 25 | 8,120,617 | (6,434,008) |
| Fitimi para tatimit | | 39,711,850 | 182,888,227 |
| Tatimi mbi fitimin | 26 | (4,788,970) | (19,076,897) |
| **Fitimi neto i vitit** | | **34,922,880** | **163,811,330** |
| **Të ardhura përmbledhëse te tjera, neto nga tatimi mbi fitimi** | | - | - |
| **Fitimi neto për periudhën, që i atribuohet aksionerëve** | | **34,922,880** | **163,811,330** |

Shënimet në faqet 7 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

## Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

*(Vlera ne Lek)*

| | Kapitali aksionar | Rezerva Ligjore | Rezerva të Tjera | Fitimi i Mbartur | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja më 1 Janar 2010** | 1,493,040,000 | 29,987,807 | 18,727,426 | 303,813,462 | 1,845,568,695 |
| **Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën** | | | | | |
| Fitimi neto i vitit | - | - | - | 163,811,330 | **163,811,330** |
| Te tjera te ardhura përnbledhëse në neto të tatimit mbi fitimin | - | - | - | - | - |
| Totali i të ardhurave përnbledhëse të periudhës | - | - | - | 163,811,330 | **163,811,330** |
| **Transaksione me pronarët, të regjistruara direkt në kapital** | | | | | |
| **Kontributi nga pronarët** | | | | | |
| Shpërndarja e fitimeve të mbartura | - | - | 14,346,808 | (14,346,808) | - |
| Pagesa për dividentë | - | - | - | (272,589,362) | **(272,589,362)** |
| **Totali i transaksioneve me pronarët** | - | - | **14,346,808** | **(286,936,170)** | **(272,589,362)** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2010** | **1,493,040,000** | **29,987,807** | **33,074,234** | **180,688,622** | **1,736,790,663** |

# Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

## Pasqyra e ndryshimit të kapitalit (vazhdim)

*(Vlera ne Lek)*

| | Kapitali aksionar | Rezerva Ligjore | Rezerva të Tjera | Fitimi i Mbartur | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja më 1 Janar 2011** | 1,493,040,000 | 29,987,807 | 33,074,234 | 180,688,622 | 1,736,790,663 |
| **Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën** | | | | | |
| Fitimi neto i vitit | - | - | - | 34,922,880 | **34,922,880** |
| Te tjera te ardhura përmbledhëse në neto të tatimit mbi fitimin | - | - | - | - | - |
| Totali i të ardhurave përmbledhëse të periudhës | - | - | - | 34,922,880 | **34,922,880** |
| **Transaksione me pronarët, të regjistruara direkt në kapital** | | | | | |
| **Kontributi nga pronarët** | | | | | |
| Shpërndarja e fitimeve të mbartura | | | 8,190,566 | (8,190,566) | - |
| Pagesa për dividentë | - | - | - | (155,620,764) | **(155,620,764)** |
| **Totali i transaksioneve me pronarët** | - | - | **8,190,566** | **(163,811,330)** | **(155,620,764)** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2011** | **1,493,040,000** | **29,987,807** | **41,264,800** | **51,800,172** | **1,616,092,779** |

Shënimet në faqet 7 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k

## Pasqyra e flukseve monetare

## për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

*(Vlerat ne Lek)*

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| **Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | | |
| **Fitimi neto i periudhës:** | 34,922,880 | 163,811,330 |
| *Rregullime për:* | | |
| Amortizim | 177,127,331 | 174,629,214 |
| Humbje nga shitja e aktiveve materiale | 1,274,648 | 565,627 |
| Nxjerrje jashtë përdorimi e aktiveve materiale | 14,015,619 | 28,142,042 |
| Provizion për inventarin | 5,218,196 | - |
| Tatim fitimi | 4,788,970 | 19,076,896 |
| Të ardhura nga interesi | (7,974,474) | (15,106,587) |
| Të ardhura nga dividente | (520,674) | (664,973) |
| Shpenzime interesi | - | 120,663 |
| **Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues:** | **228,852,496** | **370,574,212** |
| Ndryshimi në inventarë | (70,497,306) | 50,057,028 |
| Ndryshimi në mjete monetare të kushtëzuara | 62,445,500 | (62,445,500) |
| Ndryshimi në kërkesa për arkëtim nga palë te lidhura | (25,935,965) | 25,182,188 |
| Ndryshimi në kërkesa për arkëtim nga klientë | 29,506,569 | 21,038,282 |
| Ndryshimi i kërkesave te tjera për arkëtim | 1,913,361 | (12,605,760) |
| Ndryshimi në detyrim ndaj palëve te lidhura | (7,237,673) | (1,706,447) |
| Ndryshimi në detyrimet ndaj furnitorëve | 62,254,681 | 12,135,112 |
| Ndryshimi në detyrimet te tjera të pagueshme | (3,883,532) | (33,130,958) |
| **Mjete monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | **277,418,131** | **369,098,157** |
| Tatimi mbi fitimin i paguar | (11,608,436) | (43,418,631) |
| Interesa të paguar | - | (120,663) |
| Interesa të arkëtuar | 7,974,474 | 14,004,318 |
| **Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | **273,784,169** | **339,563,181** |
| **Mjete monetare nga aktiviteti investues** | | |
| Dividentë të arkëtuar | 520,674 | 664,973 |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale | (197,316,637) | (255,641,651) |
| Të ardhura nga shitjet e automjeteve dhe pajisjeve | 2,392,334 | 259,013 |
| **Mjete monetare neto nga veprimtaritë investuese** | **(194,403,629)** | **(254,717,665)** |

Shënimet në faqet 7 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e flukseve monetare
## për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor (vazhdim)

*(Vlerat ne Lek)*

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| **Mjete monetare nga aktiviteti financues** | | |
| Dividentë të paguar | (155,620,765) | (272,589,361) |
| Shlyerje e detyrimeve financiare | - | (4,587,393) |
| **Mjete monetare neto nga veprimtaritë e financimit** | **(155,620,765)** | **(277,176,754)** |
| Pakësimi neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to | (76,240,225) | (192,331,237) |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to në 1 Janar | 265,300,689 | 457,631,926 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor (shënimi 13)** | **189,060,464** | **265,300,689** |

Shënimet në faqet 7 deri 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për përdorim nga drejtuesit e Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k.më 28 Mars 2012, në emër të Bordit të Drejtorëve, dhe u firmosën nga:

Fatime Lalo
Shefe Kontabiliteti

Luigi Verardo
Drejtor i Përgjithshëm

### 1. Historiku i Shoqërisë

Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar në Qershor të 1993, si një shoqëri me kapital të përbashkët ndërmjet Aziende Commerciali Industriali e Servizi s.r.l. ("ACIES") një shoqëri italiane me zyrat qëndrore në Bolonja, Itali; The Coca-Cola Export Corporation ("TCCEC"), e themeluar në shtetin e Delware, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe Invest P.F., një Shoqëri shqiptare me kapital shtetëror me zyrat qëndrore në Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria është angazhuar në prodhimin, mbushjen dhe shitjen e të gjitha produkteve të markës Coca-Cola në Shqipëri, sipas një kontrate franchize ekskluzive me Shoqerine Coca-Cola.

Aksionerët e shoqërisë dhe kuotat e aksioneve respektive janë si më poshtë:

| | Në % | |
|---|---|---|
| **Aksionarët** | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
| ACIES S.r.l. | 51.69 | 51.69 |
| SIBEG S.r.l. | 23.00 | 23.00 |
| TCCEC | 22.65 | 22.65 |
| INVEST P.F. | 2.66 | 2.66 |
| | **100.00** | **100.00** |

Shoqëria është vendosur në Kashar, 5 km nga Tirana (Shqipëri) dhe kishte 277 punonjës në 31 Dhjetor 2011 (2010: 253 punonjës).

### 2. Baza e përgatitjes

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar (SNRF).

#### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.

#### (d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, emuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre emuarjeve.

Emuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e emuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.Në vecanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, jepet në paragrafët më poshtë:

**2. Baza e përgatitjes (vazhdim)**

**(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

*(i) Humbje nga rënia e vlerës së aktiveve financiare*

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlerë. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në fitim ose humbje, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që të ketë një rënie te matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të mund te identifikohet me nje ekspozim individual në atë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientit në Shoqëri, apo në gjendjen ekonomike lokale apo kombëtare që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

*(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një emim tregu të dallueshëm, kërkohet përdorimi i teknikave vlerësuese sic përshkruhet në shënimin 4 të pasqyrave financiare.

*(iii) Përllogaritja e tatim fitimit*

Duke filluar nga 1 Janari 2008, Shoqëria ka aplikuar Standardet Ndërkombëtare Financiare të Raportimit si kuadër kontabël statutor. Për rrjedhojë, aplikimi Standardeve Ndërkombëtare Financiare te Raportimit, siguron bazën për regjistrimet themelore kur entiteti është subjekt i tatimit mbi fitimin. Sidoqoftë, ekzistojnë udhezime të kufizuara mbi përllogaritjen e tatimit mbi fitimin si pasoje e hyrjes se Standardeve Ndërkombëtare Financiare te Raportimit si kuader kontabël per qellime ligjore. Drejtimi beson se përllogaritja e tatimi mbi fitimin është e përshtatshme duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues ne fuqi dhe rezultatet e ndonjë inspektimi te ardhshëm tatimor, nuk do te kenë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatin operativ apo flukset monetare të Shoqërisë.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar qëndrueshëm në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

### 3. Përmbledhja e politikave kontabël

#### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje, përvee diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka) të cilat janë njohur si të ardhura të tjera përmbledhëse.

#### (b) Instrumentet financiare

(i) Aktivet financiare

Shoqëria njeh fillimisht kërkesat e arketueshme në datën e lindjes së tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (përfshirë aktivet e mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse ka) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria eregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi të, flukset monetare që rrjedhin nga aktivi financiar përfundojne, ose kur transferon të drejtat mbi flukset monetare kontraktuale të aktivit në një transaksion sipas të cilit transferohen të gjitha përfitimet dhe rreziqet e pronësise. Edo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose të shlyejë vlerën neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Shoqëria ka aktive financiare të cilat përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe aktive financiare të disponueshme për shitje të cilat diskutohen më gjerë në vijim:

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogarite rrjedhëse në banka. Për qëllime të pasqyrës së fluksit te mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat të pakufizuara me maturitet te mbetur 3 muaj ose me pak.

*Kërkesa për arkëtim*

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me koston e amortizuar të pakësuar me humbjet për zhvlerësime.

*Investimet kapitale*

Investimet kapitale janë klasifikuar si aktive financiare të mbajtura për shitje. Në vijim të njohjes fillestare, ato janë matur me vlerën e drejtë dhe diferencat e krijuara, përvec humbjeve nga zhvlerësimet (shiko shënimin 3. g.i.) .

## 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

### (b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

(ii) Detyrimet Financiare

Shoqëria fillimisht njeh detyrimet në datën e krijimit. Të gjithë detyrimet financiare (duke përfshirë detyrimet të dizenjuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim ose humbje,nëse ka) fillimisht njihen në datën kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e një instrumenti. Shoqëria eregjistron detyrimet financiare nëse të detyrimet kontraktuale janë shlyer, anulluar ose ju ka kaluar afati.
Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyren e pozicionin financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.
Shoqëria ka detyrime financiare të përbëra nga llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Këto detyrime financiare fillimisht njiihen me vlerën e tyre të drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Në vijim te njohjes fillestare keto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metoden e interesit efektiv.

*Llogari të pagueshme dhe te tjera te pagueshme*

Llogari të pagueshme dhe të tjera njihen në vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar.

*Të tjera*

Instrumenta të tjera financiare jo-derivative maten në koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### (c) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

Kontabilizimi per te ardhurat dhe shpenzimet financiare është diskutuar ne shenimin 3(l).

## 3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

### (d) Aktive afatgjata materiale

*(i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto ose kosto të supozuar te pakesuar per amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, (nëse ka).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të atribueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nese perfshihet ne punime), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, koston e cmontimit dhe te zhvendosjes se njësive, kthimin e vendqëndrimit ku ato ndodhen dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes. Shpenzimet kapitale për kontributin në aktive kalojnë në llogarinë "Punime në proces" dhe kapitalizohet duke u transferuar në kategorinë e aktivit përkatës kur ai ka mbaruar, e në këtë kohë fillon dhe aplikohet amortizimi me normën përkatëse të kategorisë.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veeanta të aktiveve afatgjata materiale.

Humbje ose fitimi nga shitja e një aktivi afatgjatë material përcaktohet nga krahasimi i të ardhurave nga shitja me vlerën kontabël të aktivit afatgjatë material, dhe vlera neto njihet në te ardhura te tjera/shpenzime te tjera, në pasqyrën e të ardhurave.

*(ii) Kostot e vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi bazohet në koston e aktivit afatgjatë material minus vlerën e tij të rikuperueshme. Komponentë të rëndësishëm të aktiveve të veeanta trajtohen individualisht dhe nëse ndonjë komponent ka jetëgjatësi të ndryshme nga pjesa tjetër e aktivit afatgjatë material ai komponent amortizohet individualisht.

Amortizimi i tokës me qera, ndërtesave dhe instalimeve teknike llogaritet me metoden lineare, ndërsa amortizimi i pajisjeve të tjera llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit e cila është e perafert me jeten ekonomike. Toka dhe punimet ne proces nuk amortizohen. Normat respektive të amortizimit per periudhen raportuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

| | **2011** |
|---|---|
| E drejta e Perdorimit te tokes | 1.01% |
| Ndërtesa | 5% |
| Makineri dhe pajisje | 20% |
| Mjete transporti | 20% |
| Ambalazh i kthyeshem dhe frigoriferë | 20% |
| Pajisje zyrash, mobilje dhe orendi | 20-25% |

Jeta e dobishme, metoda e amortizimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk është e parendesishme) të aktiveve materiale afatgjate janë rishikuar në datën e raportimit.

## 3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

### (e) Aktivet e marra me qira

Aktivet e marra me qira janë te klasifikuara si qira financiare kur termat e qirasë transferojnë të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë te qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera janë të klasifikuara si qira operative.

Aktivet që janë rregjistruar si qira financiare rregjistrohen si aktive te Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qirasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qirasë nëse kjo e fundit është me e vogel. Detyrimi korrespondues ndaj qiradhenesit eshte paraqitur ne pasqyren e pozicionit financiar si detyrim per qira financiare.

Pagesat e qirasë regjistrohen si pjesë e shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qirasë në mënyrë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare jane njohur ne pasqyren e te ardhurave.

### (f) Inventarët

Mallrat vlerësohen me vlerën me te vogël midis kostos dhe vlerës neto te realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera qe janë shpenzuar për te sjelle inventarët ne gjendjen dhe vendin aktual. Shpenzimet e përgjithshme bazohen në kapacitetin operativ normal.

Vlera neto e realizueshme perfaqeson vlerën e llogaritur te cimit te shitjes ne aktivitetin normal te biznesit, te pakesuar per koston e cmuar te marketingut, shitjes dhe shpërndarjes.

Kostoja e inventarëve te tjerë është bazuar ne parimin FIFO (e hyra e pare e dala e pare) dhe përfshin shpenzimet e përdorura ne përvetësimin e inventarit dhe për ti sjelle ato ne kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet ne fitim ose humbje kur ka një evidence objektive qe aktivi është zhvlerësuar.

3. **Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

**(g) Zhvlerësimi**

*(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet per t'u zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e emuara të ardhshme të mjeteve monetare të atij aktivi financiar.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë mosshlyerje nga një debitor, konvertimin e një shume të pagueshme ndaj Shoqërise në termat që Shoqëria ose Shoqëria mëmë nuk do ta konsideronte ndryshe, tregues që një debitor ose furnizues do të deklarojë falimentin, zhdukja e një tregu aktiv për letra me vlerë.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv. Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar te vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës se tij te drejte aktuale.

Te gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyren e te ardhurave. Ndonjë humbje kumulative ne lidhje me aktivet financiare te vlefshme për shitje te njohura me pare ne të tjera të ardhura përmbledhëse transferohet në pasqyren e te ardhurave.

Një humbje nga zhvlerësimi mund të anullohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, anullimi njihet në fitim ose humbje.

### 3. Përmbledhje te politikave kontabël (vazhdim)

#### (g) Zhvlerësimi (vazhdim)

*(ii) Aktivet jo-financiare*

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përvee inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në edo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Humbjet nga zhvlerësimi ne periudhat e mëparshme janë rishikuar ne edo date raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston me. Një humbje zhvlerësimi anullohet nëse ka patur ndryshim ne vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës se rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anullohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

#### (h) Përfitimet e punonjësve

*Sigurime shoqërore te detyrueshme*

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

*Leje vjetore te paguara*

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjate periudhës.

#### (i) Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve te kaluara dhe është e mundur qe një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do te jete e nevojshme për te shlyer detyrimin dhe shuma e detyrimit mund te vleresohet ne menyre te besueshme. Provigjionet llogariten duke skontuar vlerën e pritshme te mjeteve monetare te ardhme para tatimit qe reflekton vlerësimet aktuale te tregut për vlerën ne kohe te parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik ndaj detyrimit. Provigjionet rishikohen ne edo date raportimi dhe nëse nuk është akoma e mundur qe te kerkohet nje rrjedhje e burimeve duke personifikuar burime ekonomike për shlyerjen e detyrimeve, provigjionet anullohen. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimet per te cilat njohen fillimisht. Provigjionet nuk njihen për humbje te ardhme operative.

3. **Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)**

**(j) Njohja e te ardhurave**

*(i) Produkte dhe mallra*

Te ardhurat maten me vlerën e drejte të shumës se marre ose për tu arkëtuar për te mirat dhe shërbimet te siguruara gjate aktivitetit normal te biznesit, neto nga kthimet, zbritjet tregtare uljet e emimit të bazuara në volume. Të ardhurat njihen kur ekziston evidence bindëse, zakonisht në formën e një marrëveshje shitje të ekzekutuar, që rreziqet dhe përfitimet domethenese të pronësisë i janë transferuar blerësit, është e mundur marrja e shumës së konsideruar, kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme të të mirave janë të vlerësueshme në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të manaxhimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse është e mundur që zbritjet do të ekzekutohen dhe shuma e tyre është e matshme në mënyrë të besueshme, atëherë zbritjet njihen si pakësim i të ardhurave në momentin e njohjes së të ardhurave.

Momenti i transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve varion në varësi të termave individual të kontratës së shitjes. Për shitjet e produkteve industriale dhe tregtare transferimi ndodh kur produktet jane ngarkuar ne mjetin perkates te transportit, vetem nese marreveshja e shkruar shprehet ndryshe.

*(ii) Shërbimet*

E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në fitim ose humbje në proporcion me etapën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Etapa e përfundimit është vlerësuar nga referencat e vëzhgimeve të punës së kryer.

**(k) Rimbursimet e kostos se marketingut dhe kostove te shitjes**

Rimbursimet për programet e marketingut për te promovuar shitjen e produkteve te licensuara janë te njohura si te ardhura te vitit ne te cilin kanë ndodhur dhe shpenzimet përkatëse. Rimbursimi i kostove te shitjes është njohur si e ardhur ne te njëjtën kohe me shitjet e produkteve të cilave i referohet.

**(l) Shpenzimet**

*Pagesat e qirave*

Pagesat e bëra për qiratë operacionale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjate periudhës se qirasë. Stimujt e qirasë se marre njihen si një pjese integrale e shpenzimeve totale te qirasë, gjate periudhës se qirasë.

Minimumi i pagesave të qirasë të bëra nën qiratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në edo periudhë të termave të qirasë për të krijuar nje norme interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

*Te ardhura dhe shpenzime financiare*

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e invetsuara në depozita bankare, fitimet nga shitjet e aktiveve financiare të gatshme për shitje dhe fitimet neto nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, skonto të pazbritshme mbi provigjonin, humbjet neto nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i njohur për aktivet financiare. Të gjitha kostot e huave që nuk i atribuohen direkt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aktivi njihen ne pasqyren e te ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 3. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

#### (m) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyren e te ardhurave përvee pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe edo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshem.

Tatimi i shtyre është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vleres se perdorur per qellime tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor ne fuqi ose qe hyn ne fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do te jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivet tatimore të shtyra janë rishikuar në edo datë raportimi dhe janë pakësuar për pjesën mbi të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitimi fiskal.

#### (n) Standarte dhe interpretime te reja ende te pa-adoptuara

Për periudhat që fillojnë pas dates 1 Janar 2011 janë bërë efektive një seri standartesh të reja, rishikime dhe interpretime të atyre ekzistuese të cilat nuk janë aplikuar në pregatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë efekt relevant në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

### 4. Përcaktimi i vlerës se drejtë

Disa nga politikat kontabël dhe shënimet e pasqyrave financiare të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës se drejte, për detyrimet dhe aktivet financiare dhe ato jo-financiare. Vlera e drejte e mjeteve monetare dhe atyre ekuivalente me to, e kerkesave per arketim nga debitoret dhe e llogarive te pagueshme jane pothuajse te njejta me vleren kontabel te tyre per shkak te maturitetit te tyre afatshkurter.

### 5. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

-risku i kredisë
-risku i likuiditetit
-risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë përfshire në këto pasqyra financiare.

Menaxhimi mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut. Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvilloje një ambjent kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Shoqëria Mëmë mbikëqyr se si drejtuesit monitorojnë përputhshmëritë me politikat, procedurat e rishikimet e administrimit te riskut të Shoqërisë me ato të Grupit, si dhe rishikon përshtatshmërinë e kuadrit te administrimit te riskut ne lidhje me rreziqet me te cilat përballet Shoqëria. Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat e parave në arkë dhe në banke, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

*Ndryshimet e shpeshta ne tregjet financiare globale dhe ne Shqipëri*

Kriza e vazhdueshme financiare dhe ekonomike ka ndikuar, midis te tjerash, ne një financim me te paket te tregjeve te kapitaleve, nivele likuiditeti me te ulëta në sektorin bankar, si dhe ndonjë here norma interesi nderbankar me te larta dhe luhatje te shpeshta ne tregjet e aksioneve. Paqartësitë ne tregjet financiare globale kane sjelle edhe falimentimin e bankave si dhe ndihmave te dhëna ndaj bankave te tjera përgjatë gjithë globit. Shtrirja e plote e ndikimit te krizës financiare ne vazhdim është duke provuar qe është e pamundur qe te parashikohet ose te jesh i mbrojtur plotësisht kundrejt saj.

*Ndikimi ne likuiditete*

Volumi i shitjeve me shumice është reduktuar ne mënyre te ndjeshme së fundmi. Rrethana te tilla mund te ndikojnë aftësinë e Shoqërisë te marre hua te reja, nëse është e nevojshme.

*Impakti në debitor dhe huamarrës*

Debitorët e Shoqërisë mund të ndikohen nga situata me likuiditet të ulet e cila mund të ulë aftësinë e tyre për te paguar. Përkeqësimi i kushteve operative për debitorët mund te ndikojnë gjithashtu parashikimet e menaxhimit per mjetet monetare dhe supozimet e zhvlerësimeve te aktiveve financiare dhe jo-financiare. Për sa kohe informacioni është i vlefshëm, menaxhimi ka reflektuar ne mënyrë te sakte parashikimet e mjeteve monetare te ardhme ne zhvlerësimet e tyre.

### 5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

**Risku i kredisë**

Ne saje te volumit te madh dhe diversitetit se bazes se klientëve te Shoqërisë, përqendrimet e riskut te kredisë ne lidhje me llogarite e arketueshme janë te limituara. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme mbahet në shumën e konsideruar te nevojshme për te mbuluar riskun potencial ne mbledhjen e balancave te llogarive te arketueshme.

**Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria do të hasë vështirësi për të përmbushur detyrimet financiare të cilat shlyhen nëpërmjet pagesave ne mjete monetare ose nepermjet nje aktivi tjeter financiar.

Shoqëria gjeneron mjete monetare nga aktivitetet operacionale aq sa beson se risku i likuiditetit nuk është domethënës. Për te reduktuar ketë risk Shoqëria ka lehtësime te vlefshme kredie për te financuar mjete monetare afatshkurta, nëse është e nevojshme.

**Risku i tregut**

Risku i tregut është risku që ndryshimet në cmimet e tregut, si këmbimi valutor, normat e interesit dhe emimi i kapitalit do të influencojnë të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumentave të saj financiarë. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin brenda parametrave të pranueshëm ndërkohë që optimizon kthimet.

**Administrimi i kapitalit**

Politika e Shoqërisë është të mbaje një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe te mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Menaxhimi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura operative neto ndaj totalit të kapitalit. Menaxhimi dhe Bordi monitoron gjithashtu nivelin e divídenteve për aksionet e zakonshme.

Nuk ka ndryshime në përqasjen e Shoqërisë për menaxhimin e kapitalit gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

## 6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 paraqiten si më poshtë:

| | Tokë | E drejta e perdorimit te tokes | Ndërtesa | Makineri dhe Pajisje | Mjete transporti | Automjete me qira financiare | Ambalazh i rikthyeshëm, frigorifere dhe paj.publicitare | Mobilje dhe Pajisje zyre | Te Tjera | Punime ne proces | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Kostoja*** | | | | | | | | | | | |
| Më 1 Janar 2010 | 7,600,210 | 62,700,000 | 694,457,251 | 1,435,924,058 | 151,412,307 | 33,405,720 | 294,487,685 | 103,209,979 | 2,894,665 | 1,778,808 | 2,787,870,683 |
| Shtesa | - | - | 19,677,032 | 55,784,682 | 17,375,515 | - | 69,244,938 | 8,951,313 | 384,220 | 84,223,951 | 255,641,651 |
| Transferime | - | - | - | - | 33,405,720 | (33,405,720) | - | - | - | - | - |
| Pakësime | - | - | - | - | - | - | (1,573,854) | (31,000) | - | - | (1,604,854) |
| Nxjerrje nga përdorimi | - | - | - | (24,197,300) | (14,030,547) | | (56,119,389) | (5,225,059) | (160,513) | - | (99,732,808) |
| Më 31 Dhjetor 2010 | 7,600,210 | 62,700,000 | 714,134,283 | 1,467,511,440 | 188,162,995 | - | 306,039,380 | 106,905,233 | 3,118,372 | 86,002,759 | 2,942,174,672 |
| Shtesa | - | - | 17,812,148 | 57,876,867 | 30,201,530 | - | 43,871,735 | 21,262,834 | 82,649 | 26,208,874 | 197,316,637 |
| Transferime | | | 47,995,925 | 62,436,900 | | | | | | (110,432,825) | - |
| Pakësime | - | - | - | - | (11,014,009) | - | (4,199,317) | (71,373) | - | - | (15,284,699) |
| Nxjerrje nga përdorimi | - | - | - | (82,324,503) | (9,363,506) | - | (21,685,284) | (4,879,324) | (110,800) | - | (118,363,417) |
| Më 31 Dhjetor 2011 | 7,600,210 | 62,700,000 | 779,942,356 | 1,505,500,704 | 197,987,010 | - | 324,026,514 | 123,217,370 | 3,090,221 | 1,778,808 | 3,005,843,193 |
| ***Amortizimi i akumuluar*** | | | | | | | | | | | |
| Më 1 Janar 2010 | - | (10,132,320) | (102,441,704) | (1,114,954,202) | (103,640,952) | (14,907,742) | (110,830,121) | (63,322,762) | (279,508) | - | (1,520,509,311) |
| Amortizimi i vitit | - | (633,270) | (35,217,058) | (69,458,871) | (10,817,110) | (3,699,597) | (44,766,951) | (10,036,357) | - | - | (174,629,214) |
| Transferime | - | - | - | - | (18,607,339) | 18,607,339 | - | - | - | - | - |
| Pakësime | - | - | - | - | - | - | 751,771 | 28,442 | - | - | 780,213 |
| Nxjerrje nga përdorimi | - | - | - | 15,553,249 | 11,072,382 | - | 40,104,164 | 4,799,242 | 61,730 | - | 71,590,767 |
| Më 31 Dhjetor 2010 | - | (10,765,590) | (137,658,762) | (1,168,859,824) | (121,993,019) | - | (114,741,137) | (68,531,435) | (217,778) | - | (1,622,767,545) |
| Amortizimi i vitit | - | (633,270) | (36,916,442) | (66,762,034) | (16,925,736) | - | (43,915,665) | (11,974,184) | - | - | (177,127,331) |
| Transferime | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Pakësime | - | - | - | - | 9,368,085 | - | 2,223,147 | 26,486 | - | - | 11,617,718 |
| Nxjerrje nga përdorimi | - | - | - | 76,811,755 | 8,165,084 | | 15,364,013 | 4,006,945 | - | - | 104,347,797 |
| Më 31 Dhjetor 2011 | - | (11,398,860) | (174,575,204) | (1,158,810,103) | (121,385,586) | - | (141,069,642) | (76,472,188) | (217,778) | - | (1,683,929,361) |
| ***Vlera kontabël*** | | | | | | | | | | | |
| Më 1 Janar 2010 | 7,600,210 | 52,567,680 | 592,015,547 | 320,969,856 | 47,771,355 | 18,497,978 | 183,657,564 | 39,887,217 | 2,615,157 | 1,778,808 | 1,267,361,372 |
| Më 31 Dhjetor 2010 | 7,600,210 | 51,934,410 | 576,475,521 | 298,651,616 | 66,169,976 | - | 191,298,243 | 38,373,798 | 2,900,594 | 86,002,759 | 1,319,407,127 |
| Më 31 Dhjetor 2011 | **7,600,210** | **51,301,140** | **605,367,152** | **346,690,601** | **76,601,424** | - | **182,956,872** | **46,745,182** | **2,872,443** | **1,778,808** | **1,321,913,832** |

### 6. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Toka ne perdorim përfaqëson kontributin ne natyre nga aksionari, Invest P.F ne kapitalin aksionar. E drejta e perdorimit te tokes ne të cilën ndodhet ndërtesa e Shoqërisë është e vlefshme për nëntë dhjete e nëntë (99) vite qe nga fillimi i aktivitetit te Shoqërisë. Qirasë i mbaron afati ne vitin 2092 dhe ka një amortizim vjetor 633,270 Lek.

*Sigurime*

Nuk ka ndonjë aktiv afatgjatë material të lënë si kolateral për ndonjë kredi deri më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010.

*Amortizimi*

Amortizimi paraqitet në zërin kostoja e mallrave të shitur për vlerën 117,286,574 Lek (2010: 119,949,523 Lek) dhe në shpenzimet operative për vlerën 59,840,757 Lek (2010: 54,679,691 Lek).

### 7. Investimet

Investimi prej 27,000,000 Lek përfaqëson 2.16% te kapitalit te Shoqërisë (2010: 2.16%) investime ne kapitalin aksionar te Uji I Ftohte Tepelena Sh.p.k., një Shoqëri e ambalazhimit te ujit ne Shqipëri, Shoqëria mëmë e se cilës është ACIES, një aksionar i Shoqërisë. Investimi është i konsideruar si i vlefshëm për shitje dhe i mbajtur me kosto si pasojë e mungesës së cmuarjes së vlerës së drejtë të këtij aktivi. Investimi me 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 paraqitet si me poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| Investime me 1 Janar | 27,000,000 | 27,000,000 |
| Shtesa gjate vitit | - | - |
| Investime me 31 Dhjetor | 27,000,000 | 27,000,000 |
| Humbje nga zhvlerësimi për investimet | (4,000,000) | (4,000,000) |
| Investimet neto me 31 Dhjetor | **23,000,000** | **23,000,000** |

Gjatë vitit 2007 Shoqëria njohu një humbje për zhvlerësim të investimit bazuar në rezultatin financiar të "Uji i Ftohtë Tepelenë".

### 8. Tatimi i shtyrë për aktivet/(detyrimet)

Më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010, tatimi i shtyrë i aktiveve dhe detyrimeve i atribuohet zërave të mëposhtëm:

| | Aktivet | | Detyrimet | | Neto | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2011** | **2010** | **2011** | **2010** | **2011** | **2010** |
| Aktivet materiale | - | - | (20,092,608) | (21,874,632) | (20,092,608) | (21,874,632) |
| Aktivet jomateriale | - | 6,071 | - | - | - | 6,071 |
| Investime financiare | 400,000 | 400,000 | - | - | 400,000 | 400,000 |
| Inventari | 521,820 | - | - | - | 521,820 | - |
| Qera Financiare | - | - | - | - | - | - |
| Shpenzimet e përllogaritura | - | 229,797 | - | - | - | 229,797 |
| **Tatimi i shtyrë neto** | **921,820** | **635,868** | **(20,092,608)** | **(21,874,632)** | **(19,170,788)** | **(21,238,764)** |

### 9. Inventarët

Inventarët më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 mund të përmblidhen si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| Materiale te para | 141,050,859 | 110,492,486 |
| Produkte të përfunduara | 87,201,682 | 55,916,309 |
| Karburante | 12,260,802 | 3,607,242 |
| Provigjione për inventarë jashtë përdorimi | (5,218,196) | - |
| | **235,295,147** | **170,016,037** |

### 10. Kërkesa për arkëtim nga debitorët

Kërkesat për arkëtim më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 përfaqësojnë te arkëtueshmet nga shitja e produkteve dhe atyre për rishitje. Në fund të vitit nuk është njohur ndonjë zhvlerësim për kërkesat e arkëtueshme nga debitorët.

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| Aes | 7,088,864 | 10,977,985 |
| Fedor | 6,605,529 | 8,991,400 |
| Zhan 92 | 6,592,364 | 8,070,726 |
| Euromax | 6,098,513 | 7,138,107 |
| Firma indi 2000 | 5,664,614 | 5,664,614 |
| Argo | 5,552,051 | 15,434,370 |
| Fabi-al | 3,632,823 | 3,322,082 |
| Foodway shpk | 1,717,647 | 1,110,524 |
| Mercator-a shpk | 1,684,086 | 1,480,544 |
| Armir | 1,661,892 | 194,418 |
| Bardhi 2007 | 1,000,562 | 3,999,538 |
| A&b-2 | - | 11,572,488 |
| Other | 9,050,071 | 7,898,789 |
| | **56,349,016** | **85,855,585** |

Deri në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare janë arkëtuar 45,309,397 Lek nga kërkesat për arketim të debitorëve të datës 31 Dhjetor 2011.

## 11. Kërkesa për arkëtim nga palë te lidhura

Shuma e kërkesave për arkëtim nga palët e lidhura përfshin pjesën e mbetur për arkëtim nga TCCEC ("S.A. Coca Cola Services N.V.") për rimbursimin e kostove te marketingut sipas marrëveshjes me TCCEC për të mbuluar një pjese te shpenzimeve të shoqërisë për marketing gjatë vitit 2011 dhe 2010.

| | 31 Dhjetor 2011 | | 31 Dhjetor 2010 | |
|---|---|---|---|---|
| | Në Euro | Në Lek | Në Euro | Në Lek |
| S.A. Coca Cola Services N.V. | 149,458 | 20,764,200 | 4,710 | 653,607 |
| Uji i Ftohte Tepelene Shpk | - | 5,019,890 | - | 1,670,258 |
| ACIES S.r.l | 18,000 | 2,500,740 | - | - |
| Invest PF/Ministry of Economy | - | 1,553,760 | - | 1,553,760 |
| Crilu' Sh.p.k | - | - | - | 25,000 |
| | **167,458** | **29,838,590** | **4,710** | **3,902,625** |

Deri në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare janë arkëtuar 28,284,830 Lek nga kërkesat për arketim ndaj palëve të lidhura të datës 31 Dhjetor 2011.

## 12. Aktive te tjera

Aktivet e tjera më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 mund të përmblidhen si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| *Aktive afatshkurtra:* | | |
| Shpenzimet e parapaguara | 39,991,129 | 36,448,377 |
| Parapagime furnitorëve | 7,012,748 | 7,210,508 |
| Kontratat e sigurimit të shtyrë | 1,881,138 | 1,834,666 |
| TVSH e arkëtueshme | 467,127 | - |
| Interesa të pamaturuar | 40,804 | 1,102,269 |
| Të ardhura të pafaturuara | - | 4,687,735 |
| Parapagime ndaj personelit | 1,603 | 24,333 |
| Të tjera | 43,808 | 43,830 |
| | **49,438,357** | **51,351,718** |

## 13. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| Vlera ne arke | 645,897 | 776,931 |
| Vlera në banka | 75,570,567 | 75,484,258 |
| Depozita me afat maturimi më pak se 3 muaj | 112,844,000 | 189,039,500 |
| | 189,060,464 | 265,300,689 |
| Depozita me afat maturimi më shumë se 3 muaj | - | 62,445,500 |
| | **189,060,464** | **327,746,189** |

Depozita me afat me vlerë prej 450,000 EUR ose ekuivakente me 62,445,500 Lek ishte vendosur në 2010 si garanci për fillimin e një marrëdhënie biznesi nëpërmjet një marrëveshje të firmosur në 29 Janar 2010, për sigurimin e të gjitha pajisjeve dhe sistemeve mekanike për impiantin e pastrimit të ujerave të ndotura të Coca Cola Bottling Shqiperia Shpk.

## 14. Kapitali aksionar

Më 31 Dhjetor 2011 vlera e kapitalit aksionar të autorizuar, rregjistruar dhe paguar të Shoqërisë është 1,439,040 aksione (2010: 1,439,040 aksione) me vlere prej Lek 1,000 për aksion. Më poshtë jepet përmbledhja e kuotave te kapitalit në fund të cdo viti:

| | 31-Dec-11 | | | 31-Dec-10 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i kuotave | Kapitali ne % | Lek | Numri i kuotave | Kapitali ne % | Lek |
| ACIES | 1.00 | 51.69 | 771,752,376 | 1.00 | 51.69 | 771,752,376 |
| SIBEG | 1.00 | 23.00 | 343,399,200 | 1.00 | 23.00 | 343,399,200 |
| TCCEC | 1.00 | 22.65 | 338,173,560 | 1.00 | 22.65 | 338,173,560 |
| Invest P.F. | 1.00 | 2.66 | 39,714,864 | 1.00 | 2.66 | 39,714,864 |
| | **4.00** | **100** | **1,493,040,000** | **4.00** | **100** | **1,493,040,000** |

Shoqëria nuk ka të drejta, preferenca dhe frenime lidhur me kapitalin aksionar më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010.

## 15. Rezerva ligjore

Sipas ligjit te mëparshëm shqiptar të shoqërive tregtare, shoqërive tregtare u kërkohej të transferonin minimalisht pesë përqind të të ardhurave vjetore, sie paraqitet në pasqyrat financiare për qëllime ligjore, në rezerva ligjore, derisa kjo rezervë të barazonte një të dhjetën e kapitalit aksionar dhe kjo rezervë nuk mund të shpërndahej. Me 14 Prill 2008 hyri në fuqi një ligj i ri i për shoqëritë tregtare i cili nuk kërkon që shoqëritë me përgjegjësi te kufizuar te njohin ndonjë rezerve për qëllime ligjore. Përdorimi i këtyre rezervave ligjore kryhet sipas gjykimit së aksionerëve.

### 16. Detyrimet ndaj palëve të lidhura

Detyrimet ndaj palëve të lidhura më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| ***Detyrime afatshkurtra*** | | |
| Crilu' Shpk | 515,796 | 6,829,344 |
| Uji Ftohte Tepelene Shpk | 350,745 | 1,274,870 |
| | **866,541** | **8,104,214** |

### 17. Furnitorët

Furnitorët më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| Ferra & CO | 35,148,417 | 32,266,141 |
| Artenius Hellas | 28,671,727 | 15,738,464 |
| Atlantic Industries Ltd | 25,999,357 | 62,590 |
| Rexam Beverage Can Italia S.r.l | 18,133,258 | 7,042,902 |
| Resilux | 14,901,940 | - |
| Dimapak | 8,225,260 | 7,728,591 |
| Mondial Frigo S.p.a | 7,447,791 | 7,439,214 |
| Diezela | 6,840,000 | 3,614,000 |
| Cara shpk | 6,015,105 | 578,282 |
| SIPA | 5,696,130 | - |
| OMF | 3,519,097 | 3,515,044 |
| Top Channel | 3,314,460 | 3,409,269 |
| Salillari | 3,151,766 | 2,557,418 |
| Bold | 3,114,009 | 3,110,423 |
| Granzotto | 2,797,828 | - |
| Europetrol Albania | 2,665,000 | - |
| Status | 2,520,521 | - |
| Genial | 1,904,548 | - |
| Strammiello Trasporti | 579,338 | 101,623 |
| Euroconstruction Company | - | 34,345,575 |
| Bericap | - | 4,033,594 |
| Sofigaz | - | 3,814,063 |
| Other | 29,882,699 | 18,916,377 |
| | **210,528,251** | **148,273,570** |

### 18. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2011 | 31 Dhjetor 2010 |
|---|---|---|
| TVSH e pagueshme | - | 3,682,720 |
| Parapagime nga klientët | 38,959,117 | 32,705,720 |
| Shpenzime të përllogaritura | 12,773,965 | 6,084,310 |
| Personeli | 14,576,158 | 13,494,090 |
| Tatimi mbi të ardhurat e personelit | 7,944,064 | 6,417,189 |
| Akcizë e pagueshme | 9,777 | 15,040,454 |
| Zbritje mbi shitjet | - | 1,980,848 |
| Dividentë të pagueshëm | 1,553,760 | 1,553,760 |
| Të tjera | 3,653,720 | 2,395,003 |
| | **79,470,561** | **83,354,094** |

### 19. Dividendët

Shpërndarja e dividentëve përcaktohet sipas vendimit të aksionerëve. Më 22 Prill 2009 mbledhja e asamblesë së aksionarëve të C.C.B.S. Shpk aprovuoi shpërndarjen e dividendit për vitin fiskal 2009.

| | |
|---|---|
| Dividentë të pagueshëm më 01 Janar 2010 | 1,553,760 |
| Fitimi neto për vitin 2009 | 286,936,170 |
| Transferimi në rezerva | 14,346,808 |
| Dividentë të paguar në 2010 | 272,589,362 |
| Dividentë të pagueshëm | 1,553,760 |

Ndërkohë, më 12 Prill 2011, mbledhja e asamblesë së aksionarëve miratoi shpërndarjen e dividendit për vitin fiskal 2010.

| | |
|---|---|
| Dividentë të pagueshëm më 01 Janar 2011 | 1,553,760 |
| Fitimi neto për vitin 2010 | 163,811,330 |
| Transferimi në rezerva | 8,190,566 |
| Dividentë të paguar në 2011 | 155,620,764 |
| Dividentë të pagueshëm | 1,553,760 |

## 20. Të ardhurat

Të ardhurat operative analizohen më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| ***Të ardhura nga shitja e produkteve te veta*** | | |
| Coca-Cola | 1,472,805,084 | 1,396,114,136 |
| Fanta Orange | 358,255,840 | 338,135,796 |
| Fanta Exotic | 435,457,198 | 410,309,250 |
| Fanta Lemon | 22,178,567 | 29,107,440 |
| Sprite | 125,411,853 | 125,948,561 |
| Schweppes | 26,214,882 | 23,597,399 |
| Lift | - | 5,119,169 |
| | 2,440,323,424 | 2,328,331,751 |
| ***Të ardhura nga shitje tregtare*** | 45,499,191 | 39,116,994 |
| | **2,485,822,615** | **2,367,448,745** |

## 21. Kostoja e mallrave te shitura

Kosto e produkteve dhe mallrave të shitur përbëhet si më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| ***Blerja e materialeve dhe të mirave*** | | |
| Koncentrati i produkteve | 527,475,683 | 469,899,151 |
| Sheqer dhe dioksid karboni | 363,738,107 | 273,210,031 |
| Materiale ambalazhimi | 547,611,711 | 437,673,304 |
| Blerja e mallrave për rishitje | 46,944,142 | 39,049,215 |
| Materiale te tjera | 98,565,025 | 79,603,397 |
| | 1,584,334,668 | 1,299,435,098 |
| ***Kosto të tjera shitjeje*** | | |
| Transporti për blerjen e materialeve | 21,727,801 | 19,764,214 |
| Transporti për shitjen e produkteve dhe mallrave | 31,151,123 | 31,132,305 |
| Shpenzime takse dhe doganore | 3,501,189 | 3,057,991 |
| Akciza për materialet ambalazhuese | 91,108,041 | 17,654,405 |
| Riparim, mirëmbajtje makineri | 35,425,647 | 30,188,368 |
| Amortizimi (referuar shënimit 6) | 117,286,574 | 119,949,523 |
| Kostoja e personelit të prodhimit | 70,659,337 | 59,508,752 |
| | 370,859,712 | 281,255,558 |
| Ndryshimi në inventar | (74,824,641) | 29,919,156 |
| | **1,880,369,739** | **1,610,609,812** |

### 22. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera përbëhen si më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| Rimbursimi për marketing dhe kosto të tjera | 107,696,942 | 27,334,779 |
| Shitja e automjeteve dhe pajisjeve | 2,375,300 | 259,013 |
| Shitja e materialeve | 767,961 | 410,926 |
| Të tjera | 8,114,994 | 9,575,049 |
| | **118,955,197** | **37,579,767** |

Shoqëria merr pjesë në programe të ndryshme marketing pjesërisht të mbështetura nga licensori i Shoqërisë, TCCEC. Në këto programe një pjesë e disa kostove të kryera nga Shoqëria janë të rimbursuara nga licensuesi i aplikueshëm. "Rimbursimi për programet e marketingut" përfshin vlera të dhëna nga TCCEC për shpenzimet e marketingut në shumën 107,696,942 Lek (2010: 23,816,821 Lek).

### 23. Personeli

Kostoja e personelit përbëhet si më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| Pagat | 193,570,150 | 142,070,726 |
| Sigurime shoqërore dhe shëndetsore | 24,700,151 | 18,973,065 |
| Të tjera | 4,669,638 | 2,691,162 |
| | **222,939,939** | **163,734,953** |

### 24. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet e tjera operative përbëhen si më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| Shpenzime reklame dhe te tjera | 145,147,512 | 137,687,804 |
| Asistence teknike dhe te tjera | 73,907,122 | 62,110,677 |
| Shpenzime nga shitja/nxjerrja nga përdorimi e AAM | 17,682,601 | 28,966,682 |
| Shërbimet nga palë të treta | 27,202,230 | 26,719,792 |
| Riparime dhe mirëmbajtje | 21,991,312 | 13,473,261 |
| Pritje dhe dhurata | 16,614,487 | 17,211,737 |
| Penalitete dhe të tjera | 623,353 | 2,124,487 |
| Udhëtime dhe dieta | 17,640,989 | 17,380,748 |
| Karburante për mjete qarkullimi | 36,897,415 | 30,596,928 |
| Inventare të nxjerra nga përdorimi | 10,579,760 | 17,671,207 |
| Provigjione për inventarë të papërdorshëm | 5,218,196 | - |
| Taksa kombëtare dhe lokale | 3,842,246 | 3,655,824 |
| Sigurime | 6,154,799 | 6,475,549 |
| Qira | 26,534,122 | 22,607,125 |
| | **410,036,144** | **386,681,821** |

## 25. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përbëhen si më poshtë:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| *Shpenzime Financiare* | | |
| Humbjet neto nga kursi këmbimit | - | (19,944,297) |
| Komisione bankare | (1,862,971) | (2,090,608) |
| Shpenzimi i interesave të qirasë financiare | - | (120,663) |
| | (1,862,971) | (22,205,568) |
| *Të ardhura Financiare* | | |
| Fitimi neto nga kursi këmbimit | 1,488,440 | - |
| Të ardhura nga dividentët | 520,674 | 664,973 |
| Të ardhura nga interesat | 7,974,474 | 15,106,587 |
| | 9,983,588 | 15,771,560 |
| | **8,120,617** | **(6,434,008)** |

## 26. Tatim fitimi

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| *Tatimi mbi fitimin për vitin aktual* | | |
| Tatimi i vitit aktual | 6,856,946 | 18,343,278 |
| Tatimi i shtyrë (e ardhur)/shpenzim | (2,067,976) | 733,619 |
| | **4,788,970** | **19,076,897** |

Tatimi mbi fitimin ne Shqipëri llogaritet me normëm prej 10% (2010: 10%) të të ardhurave të taksueshme. Më poshtë jepet një rakordim i tatim fitimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit mbi fitimin.

| | 2011 % | 2011 Lek | 2010 % | 2010 Lek |
|---|---|---|---|---|
| Fitimi neto | | 34,922,880 | | 163,811,330 |
| Tatim fitimi për vitin | | 4,788,970 | | 19,076,897 |
| Fitimi para tatim fitimit | | 39,711,850 | | 182,888,227 |
| Tatim fitimi duke përdorur normën e taksueshme te Shoqërisë | 10.0 | 3,971,185 | 10.0 | 18,288,823 |
| Shpenzime të pa zbritshme | 2.1 | 817,785 | 0.4 | 788,074 |
| **Tatim fitimi për vitin** | 12.1 | **4,788,970** | 10.4 | **19,076,897** |

## 27. Palët e lidhura

Shoqëria ka një marrëdhënie si palë e lidhur me aksionaret e saj, me shoqërinë mëmë, dhe me shoqëri te tjera qe janë nen kontrollin e shoqërisë mëmë ACIES. Shoqëria gjithashtu eshtë në marrëdhenie si palë të lidhura me drejtuesit dhe ekzekutivët e saj.
Gjate vitit ka patur transaksione me:

- TCCEC - aksionar
- ACIES S.r.l - Shoqëria mëmë
- SIBEG S.r.l. – aksionar – nën kontrollin e ACIES
- Invest PF/Ministria e Ekonomise - aksioner
- Crilu' Sh.p.k - nën kontrollin e ACIES
- Uji i Ftohte Tepelene Sh.p.k – investim në kapital

Gjate vitit shoqëria kishte këto transaksione me palët e lidhura:

| | 2011 | 2010 |
|---|---|---|
| **Blerje nga:** | | |
| Crilu Shpk | 9,938,662 | 14,582,663 |
| Uji i Ftohte Tepelene Sh.p.k | 34,401,214 | 27,223,475 |
| SIBEG S.r.l | 468,832 | 645,482 |
| ACIES S.r.l | 107,785,641 | 66,306,632 |
| **Shitje ndaj:** | | |
| Rimbursim për shpenzime marketing dhe të tjera nga TCCEC | 107,696,942 | 23,816,821 |
| Uji i Ftohte Tepelene Shpk | 8,832,800 | 3,152,810 |
| ACIES S.r.l | - | 76,307 |
| Crilu Shpk | 911,428 | 963,648 |
| SIBEG S.r.l | 14,284 | - |

Në cdo datë raportimi, në pasqyrën e bilancit janë përfshirë vlerat e mëposhtme për palët e lidhura:

| *Të pagueshme/(Të arkëtueshme)* | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
|---|---|---|
| Kërkesa për arkëtim nga Crilu Shpk | - | (25,000) |
| Detyrime ndaj Crilu Shpk | 515,796 | 6,829,344 |
| Kërkesa për arkëtim nga Uji i Ftohtë Tepelenë Shpk | (5,019,890) | (1,670,258) |
| Detyrime ndaj Uji i Ftohtë Tepelenë Shpk | 350,745 | 1,274,870 |
| Kërkesa për arkëtim nga S.A Coca Cola Services N.V (TCCEC) | (20,764,200) | (653,607) |
| Kërkesa për arkëtim nga Ministria e Ekonomisë | (1,553,760) | (1,553,760) |
| Kërkesa për arkëtim nga ACIES S.r.l. | (2,500,740) | - |
| | **(28,972,049)** | **4,201,589** |

Manaxhimi i lartë ka marrë shpërblime, për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe të Asamblesë të realizuara gjatë vitit, në shumën 2,612 mijë Lek për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (2010: 2,271 mijë Lek).

## 28. Instrumentet financiare

### Risku i kredisë

Ekspozimi ndaj riskut te kredisë:

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal te kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:

| | 31 Dhjetor | |
|---|---|---|
| | **2011** | **2010** |
| Kërkesa për arkëtim nga debitorët | 56,349,016 | 85,855,585 |
| Aktive të tjera | 1,921,942 | 2,936,935 |
| Kërkesa për arkëtim me palët e lidhura | 29,838,590 | 3,902,625 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 189,060,464 | 327,746,189 |
| | **277,170,012** | **420,441,334** |

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë për llogarite e arkëtueshme në datën e raportimit sipas rajonit gjeografik ishte:

| | 31 Dhjetor | |
|---|---|---|
| | 2011 | 2010 |
| Vendas | 56,349,016 | 85,855,585 |
| I huaj | - | - |
| | 56,349,016 | 85,855,585 |

### Humbje nga zhvlerësimi

Maturimi i llogarive te arkëtueshme në datën e raportimit ishte:

| | Bruto | Zhvlerësimi | Bruto | Zhvlerësimi |
|---|---|---|---|---|
| | 2011 | 2011 | 2010 | 2010 |
| Më pak se një vit | 46,964,898 | - | 78,550,035 | - |
| Më shumë se një vit | 9,384,118 | - | 7,305,550 | - |
| Gjendja në fund te vitit | 56,349,016 | - | 85,855,585 | - |

### 28. Instrumentet financiare (vazhdim)

**Risku i likuiditetit**

Më poshtë jepen maturitetet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare duke përfshirë pagesën e interesave më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010:

| *31 Dhjetor 2011* | **Vlera kontabël** | **6 Muaj ose më pak** | **6-12 muaj** | **1-5 Vite** | **Më shume se 5 Vite** |
|---|---|---|---|---|---|
| *Aktivet financiare* | | | | | |
| Kërkesa për arkëtim nga debitorët | 56,349,016 | 56,349,016 | - | - | - |
| Kërkesa të tjera për arkëtim | 1,921,942 | 1,921,942 | - | - | - |
| Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura | 29,838,590 | 29,838,590 | - | - | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 189,060,464 | 189,060,464 | - | - | - |
| | 277,170,012 | 277,170,012 | - | - | - |
| *Detyrimet financiare* | | | | | |
| Huatë | - | - | | - | - |
| Detyrime ndaj palëve te lidhura | 866,541 | 866,541 | - | - | - |
| Furnitorë | 210,528,251 | 210,528,251 | - | - | - |
| Detyrime të tjera | 14,327,725 | 12,773,965 | 1,553,760 | - | - |
| | 225,722,517 | 224,168,757 | 1,553,760 | - | - |

| *31 Dhjetor 2010* | **Vlera kontabël** | **6 Muaj ose më pak** | **6-12 muaj** | **1-5 Vite** | **Më shume se 5 Vite** |
|---|---|---|---|---|---|
| *Aktivet financiare* | | | - | - | - |
| Kërkesa për arkëtim nga debitorët | 85,855,585 | 85,855,585 | - | - | - |
| Kërkesa të tjera për arkëtim | 2,936,935 | 2,936,935 | - | - | - |
| Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura | 3,902,625 | 3,902,625 | - | - | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 327,746,189 | 265,300,689 | 62,445,500 | - | - |
| | 420,441,334 | 357,995,834 | 62,445,500 | - | - |
| *Detyrimet financiare* | | | | | |
| Huatë | - | - | - | - | - |
| Detyrime ndaj palëve te lidhura | 8,104,214 | 8,104,214 | - | - | - |
| Furnitorë | 148,273,570 | 148,273,570 | - | - | - |
| Detyrime të tjera | 9,618,918 | 8,065,158 | 1,533,760 | - | - |
| | 165,996,702 | 164,442,942 | 1,533,760 | - | - |

### 28. Instrumentet financiare (vazhdim)

**Risku i monedhës**

**Ekspozimi ndaj riskut të monedhës**

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të monedhës më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 ishte si më poshtë:

| *31 Dhjetor 2011* | Vlera kontabël | Euro | USD | Lek |
|---|---|---|---|---|
| Kërkesa për arkëtim nga debitorët | 56,349,016 | - | - | 56,349,016 |
| Kërkesa të tjera për arkëtim | 1,921,942 | 1,881,138 | - | 40,804 |
| Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura | 29,838,590 | 18,263,460 | - | 11,575,130 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 189,060,464 | 10,724,469 | 426,505 | 177,909,490 |
| Detyrime ndaj palëve te lidhura | (866,541) | - | - | (866,541) |
| Furnitorë | (210,528,251) | (147,397,913) | (35,148,417) | (27,981,922) |
| Detyrime të tjera | (14,327,725) | (6,003,592) | - | (8,324,133) |
| Ekspozimi neto | 51,447,495 | (122,532,438) | (34,721,912) | 208,701,844 |

| *31 Dhjetor 2010* | Vlera kontabël | Euro | USD | Lek |
|---|---|---|---|---|
| Kërkesa për arkëtim nga debitorët | 85,855,585 | - | - | 85,855,585 |
| Kërkesa të tjera për arkëtim | 2,936,935 | 1,834,666 | - | 1,102,269 |
| Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura | 3,902,625 | 653,607 | - | 3,249,018 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 327,746,189 | 257,312,824 | 157,472 | 70,275,893 |
| Detyrime ndaj palëve te lidhura | (8,104,214) | - | - | (8,104,214) |
| Furnitorë | (148,273,570) | (96,890,765) | (32,328,732) | (19,054,073) |
| Detyrime të tjera | (9,618,918) | (2,505,066) | - | (7,113,852) |
| Ekspozimi neto | 254,444,632 | 160,405,265 | (32,171,260) | 126,210,626 |

Më poshtë jepen kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

| Lek | Kursi mesatar | | Kursi në datën e raportimit | |
|---|---|---|---|---|
| | 2011 | 2010 | 2011 | 2010 |
| ***USD 1*** | 100.87 | 104.05 | 107.54 | 104.00 |
| ***EURO 1*** | 140.35 | 137.79 | 138.93 | 138.77 |

**Analiza e ndjeshmërisë**

Një forcim ose dobësim i Lek-ut kundrejt EUR dhe USD në datën 31 Dhjetor do të kishtë ndikuar respektivisht në pakësimin ose rritjen e kapitalit me shumat që paraqiten më poshtë. Kjo analizë është e bazuar në ndryshimin e kursit të këmbimit të valutave, që sipas Shoqërisë, në datën e raportimit të periudhës konsiderohet e mundshme të jetë prej 10 %. Analiza është kryer në të njëjtën mënyrë edhe për vitin 2010.

| Lek | 31 Dhjetor 2011 | | 31 Dhjetor 2009 | |
|---|---|---|---|---|
| | Kapital | Fitim ose humbje | Kapital | Fitim ose humbje |
| ***USD*** | (3,124,972) | (3,124,972) | (2,895,413) | (2,895,413) |
| ***EURO*** | (11,027,919) | (11,027,919) | 14,436,474 | 14,436,474 |

## 28. Instrumentet financiare (vazhdim)

### Risku i normës se interesit

**Profili**

Në datën e raportimit profili i interesave të Instrumentave fincanciare të Shoqërisë që bartin interesa paraqitet si më poshtë:

| | 31 Dhjetor | |
|---|---|---|
| | 2011 | 2010 |
| **Instrumenta me normë fikse** | | |
| Aktive Financiare | 112,844,000 | 251,485,000 |

### Risku i normës se interesit

**Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse**

Shoqëria nuk bën regjistrime në fitim ose humbje për ndonjë aktiv apo detyrim financiar me normë fikse në vlerën e drejtë, dhe Shoqëria nuk ka instrumenta derivative (norma e interesit sëap) si instrumenta mbrojtëse sipas një modeli kontabël mbrojtës me vlerën e drejtë . Kështu që një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikonte në fitim ose humbje

Një ndryshim me 100 pikë në normën e interesit do të rriste ose zvogëlonte kapitalin me 1,128 mijë Lek (2010: 2,515 mijë Lek).

### 29. Angazhimet dhe detyrimet e shtyra

***Procedurat ligjore***

***Çështje me Policinë Elektrike të Tiranës***

Më 31 Dhjetor 2005, Policia e Elektrike e Tiranës vendosi një gjobë prej 40 mijë Lek me pretendimin për parregullsi në sahatin e energjisë elektrike. Më 11 Janar 2006 Policia Elektrike e Tiranës vendosi një gjobë prej 9 milion Lek të njoftuar nëpërmjet aktit administrativ (p.sh vendim nr. PE 018807), me pretendimin e dëmit te shkaktuar kundrejt KESH prej parregullsive në sahatin e energjisë elektrike . Shoqeria e ka apeluar gjobën dhe Gjykata e Qarkut Tirane, me kerkesë të Shoqërisë, vendosi të pezullojë cështjen deri në gjykimin final të cështjes së parë. Në 10 Nëntor 2011, gjykata ka rikonfirmuar shkakun e pezullimit për këtë cështje. Asnjë provigjon nuk është vlerësuar dhe regjistruar në këto pasqyra financiare për shkak të pamundësisë së vlerësimit të flukseve monetare të ardhshme të mundshme, në nivelin e kërkuar të besueshmërisë.

***Cështje me Bashkinë e Tiranës***

Me marrjen e Vlerësimit të Taksave nga Drejtoria e Taksave të Bashkisë Tiranë më 10 Dhjetor 2008, shoqëria u njoftua mbi detyrimin e taksave në vlerën prej 3,968,200 Lek në lidhje me tabelat për reklamë, taksën e pastrimit dhe gjelbërimit për periudhën nga 2001 në 2008. Shoqëria ka apeluar kundër këtij detyrimi tek Kryetari i Bashkisë i cili me vendim nr.113 datë 16 Shkurt 2009 vendosi të ndryshojë pjesërisht vlerësimin e mësipërm të taksave. Shoqëria depozitoi kërkesë padinë në Gjykaten e Rrethit Tiranë, e cila e refuzoi atë nëpërmjet vendimit numër 3529 të datës 29 Prill 2010. Shoqëria e ka apeluar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila me vendim 27.09.2011 vendosi te mbajë në fuqi vendimin e Gjyaktes së Rrethit Tiranë dhe si rrjedhojë Shoqëria apeloi këtë cështje në Gjykatën e Lartë dhe është në pritje të njoftimit të datës së shqyrtimit të cështjes. Asnjë provigjon nuk është paraqitur në këto pasqyra financiare për shkak të pamundësisë së vlerësimit të flukseve te mundshme te ardhshme monetare në nivelin e duhur të besueshmërisë.

***Cështja e të drejtës së përdorimit së tokës***

Sic u diskutua në Shënimin 1 dhe 6, Shoqëria u themelua në 1993 si një investim i përbashkët midis ACIES, TCCEC dhe Qeverisë së Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë mori pjesë në kapitalin e përbashkët të këtij investimi përmes Invest P.F. duke kontribuar me përdorimin e tokës për një periudhë 99 vjet. Një grup individësh të kombësisë Shqipëtare pretendojnë të jenë Ish-Pronarë të Tokës dhe tashmë mbajnë Tapitë e Pronësise mbi tokën në përdorim të dhënë kontribut nga Qeveria e Shqipërisë. Për më tepër, Shoqëria nuk ka informacion mbi ekzistencën e Invest P.F dhe mban të gjithë korespondencën me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës që gëzon virtytin e të qënit aksioner në emër të Qeverisë së Shqipërisë. Më 23 Korrik 2009, u zhvillua një seancë gjyqësore në Gjykaten e Rrethit Tiranë midis këtij grupi individësh, shoqërisë dhe Ministrisë së Ekonomise dhe Gjykatësi vendosi të ndërpresë cështjen për shkak të procedures jo të saktë të ndjekur nga Pala Paditëse pa shqyrtuar cështjen më thellë. Me qëllim parandalimin e konflikteve të ardhshme mbi cështjen e Qiramarrjes së Tokës, Shoqëria ka paraqitur një kerkese në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Tiranë për pezullimin e pasurisë së regjistruar por e mbivendosur në tokën e dhënë me qira.Shoqëria ka dorëzuar edhe një kërkesë në Prefekturën e Rrethit Tiranë për anullimin e dokumentave të Pronësise së Tokës të cilat zotërohen nga ky grup individësh, kërkesë e cila është në shqyrtim. Gjate 2011, Reshit dhe Ramiz Locka dorezuan në Gjykatën e Rrethit të Tiranës një padi kundër Shoqerisë, ku kërkohet që pala e paditur të hyjë në kontratë qeraje me paditësin mbi përdorimin e tokës ku janë ndërtuar ambjentet e CCBS. Cështja është nën shqyrtim dhe seanca gjyqësore e radhës është caktuar më 2 Prill 2012. Menaxhimi i ka kërkuar aksionerit Invest P.F. të bëj të gjitha përpjekjet e mundshme me qëllim zgjidhjen e cështjes si edhe është në shqyrtim të iniciativave të tjera për të mbrojtur investimet dhe gjithashtu për të evituar efekte të padëshiruara mbi pozicionin financiar të CCBS dhe mbi rezultatin operativ të Shoqërisë.

## 29. Angazhimet dhe detyrimet e shtyra (vazhdim)

***Çështje me Autoritetet Tatimore***Shoqëria ka qënë subjekt i inspektimeve dhe kontrolleve të ndryshme nga autoritetet tatimore Shqiptare.

- Ne muajin Mars 2009, Shoqeria nepermjet nje kerkese te drejtuar NJTM-se, kerkoi te ndryshohej deklarimi i bere nga Shoqeria per tatim fitimin e periudhes se mbyllur me 31 Dhjetor 2007. Pas nje kontrolli tatimor, ndaj Shoqërisë u lëshua një Njoftim vlerësimi tatimor me datë 18 Nëntor 2009. Vlera totale e detyrimeve të njoftuara është afro 5.4 milion Lek, duke përfshirë kamatvonesat dhe gjobat e vendosura per deklarim te gabuar te tatim fitimit. Shoqëria apeloi këtë Njoftim vlerësimi tatimor në Drejtorinë e Apelimit, e cila redukoi detyrimin në 2,468,490 Lek. Në 4 Maj 2010, Shoqëria depozitoi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një padi kundrejt vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor duke pretenduar anullimin e Aktit Administrativ. Më 19 Shtator 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi të reduktojë vlerësimin edhe me 310,590 Lek. Shoqëria ka apeluar kundrejt këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe është në pritje të datës së gjykimit. Asnjë provigjon nuk është regjistruar në pasqyrat financiare pasi manaxhimi beson se rezultati përfundimtar do të jetë në favor të Shoqërisë.
- Në vijim të një kontrolli tatimor nga inspektorët e Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, Njoftim Vlerësimi Tatimor i lëshuar në datë 28 Tetor 2010 rivlerësoi detyrimet për taksën e akcizës me vlerën 59,637,547 Lek, duke përfshirë një gjobë prej 39,758,365 Lek për periudhën Korrik-Gusht 2010. Shoqëria e apeloi Njoftim Vlerësimin Tatimor në Drejtorinë e Apelimit Tatimor e cila vendosi të refuzojë apelimin. Shoqëria e apeloi cështjen në Gjykatën e Rrethit Tiranë e cila vendosi më 21 Dhjetor 2011 të anullojë njoftim vlerësimin tatimor. Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka apeluar këtë vendim dhe jemi në pritje të datës së seancës së gjykimit. Pretendimi i Shoqërisë bazohet në logjikën që ndryshimi i Ligjit për Akcizat i detyrueshëm për zbatim nga data 27 Korrik 2010 udhëzon që taksa e akcizës të paguhet ose (i) në doganë në rastin e importimit të të mirave me ambalazh plastik/qelqi ose vetëm në ambalazhet plastik/qelqi, ose (ii) në shitje, në rastin e prodhimit lokal të ambalazheve plastike/prej qelqi. Manaxhimi beson se ka baza të forta për rrëzimin e pretendimeve tatimore, duke marrë parasysh edhe paqartesitë në mjedisin tatimor Shqiptar, dhe manaxhimi beson se nuk është i nevojshmem ndonjë provigjon për riskun tatimor.

***Angazhimet e qirasë***

Të tilla angazhime për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 përbëhen si më poshtë:

| | **31 Dhjetor 2011** | **31 Dhjetor 2010** |
|---|---|---|
| Jo më shumë se 1 vit | 17,867,775 | 19,100,277 |
| Më shumë se 1 vit dhe më pak se 5 vjet | 16,571,017 | 1,798,160 |
| **Totali** | **34,438,792** | **20,898,436** |

## 30. Ngjarje pasuese

Manaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullim apo shënim shtesë në pasqyrat financiare.